



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
DREJTORIA E ANALIZAVE DHE PROGRAMIMIT BUXHETOR

Nr. 2985/1 Prot.

Tiranë, më 29/2/2016

Për : Ministrinë _____

Për: Institucionin Qendror _____

Subjekti: Dërgohet udhëzimi vjetor i përgatitjes së PBA 2017-2019

Bashkëngjitur gjeni për njohje dhe zbatim Udhëzimin nr.4, datë 29.02.2016 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2017-2019”.

Me respekt,

ARBEN AHMETAJ

MINISTËR





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCEVE

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
DREJTORIA E ANALIZAVE DHE PROGRAMIMIT BUXHETOR**

U D H Ë Z I M

N^o = 2985

Nr. 4 Datë 29 /02/2016

20.216

**“PËR
PËRGATITJEN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2017-2019**

Në përputhje me nenet 4 dhe 24 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe pikës 67 të Udhëzimit nr.8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, ministri i Financave;

U D H Ë Z O N:

1. Të përgjithshme

- a) Qëllimi i këtij udhëzimi është informimi i Njërive të Qeverisjes Qendrore mbi tavanet e shpenzimeve të miratuara me Vendimin e Këshillit të Ministrave, afatet kohore për përgatitjen dhe paraqitjen e kërkesave buxhetore afatmesme 2017-2019, të cilat janë miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.59, datë 27.01.2016 “Për miratimin e Kalendarit të Menaxhimit të Shpenzimeve Publike 2016”.
- b) Për procedura të detajuara mbi përgatitjen e kërkesave buxhetore, Njësitë e Qeverisjes Qendrore duhet t’i referohen përcaktimeve të Udhëzimit nr.8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, të cilat mund të shkarkohet në linkun:
<http://www.financa.gov.al/al/raportime/buxheti/udhezime>.
- c) Njësitë e Qeverisjes Qendrore, nëpërmjet sistemit informatik të Programit Buxhetor Afatmesëm, hartojnë kërkesat e tyre buxhetore. Aksesimi në këtë softwer bëhet i mundur nëpërmjet GOVNET. Për institucionet që kanë mungesë aksesimi në GOVNET, kërkesat buxhetore do të paraqiten nëpërmjet formateve standarde të rishikuara në EXCEL, të cilat mund t’i gjeni bashkëlidhur udhëzimit. Këto formate mund të shkarkohen edhe në link-un: <http://www.financa.gov.al/al/raportime/buxheti/udhezime>.

2. Përgatitja e Programit Buxhetor Afatmesëm 2017-2019

- a) Deklarata e Politikës së Programit 2017-2019, e përgatitur nga çdo Njësi e Qeverisjes Qendrore, duhet të jetë domosdoshmërisht në përputhje të plotë me qëllimet dhe objektivat e përcaktuara në Programin e Qeverisë 2013-2017, si dhe në dokumentet strategjikë të sektorëve përkatës.

- b) Së bashku me Deklaratën e Politikës së Programit 2017-2019 (*shih Pika a*), çdo Njësi e Qeverisjes Qendrore duhet të paraqesë në Ministrinë e Financave edhe **një ekstrakt të përmbledhur të prioriteteve konkrete dhe indikatorëve kryesore të performancës për vitin 2017, për çdo program.**
- c) Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.465, datë 18.07.2012 “Për integrimin gjinor në Programin Buxhetor Afatmesëm” dhe të udhëzimit të përbashkët nr.21, datë 21.06.2013 “Për përcaktimin e procedurave për integrimin gjinor në programin buxhetor afatmesëm”, të gjitha ministritë e linjës brenda një ose dy programeve buxhetore përkatëse duhet të përcaktojnë objektiva të përshtatshëm e të matshëm, të detajuara në produkte/aktivitete/kosto për arritjen e barazisë gjinore. Për të realizuar me sukses buxhetimin gjinor nisur nga sa më sipër:
- Të përdoret udhëzuesi praktik “Buxheti i Përgjegjshëm Gjinor”, të cilin e gjeni në link-un: <http://www.financa.gov.al/al/raportime/buxheti/udhezime>
 - Konsulenti i UN WOMEN, pranë Ministrisë së Financave, do të asistojë EMP e programeve në procesin e draftimit të objektivave, produkteve, aktiviteteve dhe kostove që ndikojnë në promovimin e barazisë gjinore.
- d) Tavanet Përgatitore të PBA 2017-2019 për Njësitë e Qeverisjes Qendrore do të dërgohen në një moment të dytë.
- e) Kërkesat buxhetore duhet të jenë detyrimisht brenda këtyre taveve të miratuara.
- f) Të gjitha Njësitë e Qeverisjes Qendrore, në Fazën I të Programit Buxhetor Afatmesëm, krahas raporteve standarde të kërkesave buxhetore duhet të plotësojnë dhe dorëzojnë në Ministrinë e Financave edhe pasqyrat plotësuese të projekt-buxhetit vjetor 2017, të cilat mund të shkarkohen në link-un: <http://www.financa.gov.al/al/raportime/buxheti/udhezime>
- g) Për planifikimin e investimeve të programit, Njësitë e Qeverisjes Qendrore duhet t’i referohen **Shtojcës 6** dhe formularëve përkatës në **Shtojcat 2/A dhe 2/B**, të cilat duhet të plotësohen dhe dorëzohen në Ministrinë e Financave, si edhe mund të shkarkohen në link-un: <http://www.financa.gov.al/al/raportime/buxheti/udhezime>.
- h) Në rastet kur tavanet e Programit Buxhetor Afatmesëm nuk përmbushin nevojat më të domosdoshme, Njësitë e Qeverisjes Qendrore mund të paraqesin kërkesa shtesë, sipas procedurës përkatëse të ilustruar në **Shtojcën nr.5** (seksioni H - Kërkesat Shtesë të Programit Buxhetor Afatmesëm) të Udhëzimit nr.8 datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”
- i) Kurset e Këmbimit për vitet 2010-2016 dhe parashikimi për vitet 2017-2019, që do të përdoren në planifikimin e shpenzimeve për projektet me financim të huaj, jepen si më poshtë:

Nr	Monedhat	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
1	Kurs i këmbimit mesatar Lek/USD	103.9	100.9	108.2	105.7	105.5	125.6	125.6	125.6	125.6	125.6
2	Kurs i këmbimit mesatar Lek/EURO	137.7	140.5	139	140.3	140.0	140.1	140.1	140.1	140.1	140.1

3. Përfshirja e shoqërisë civile në përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2017-2019

- a) Në kuadër të buxhetimit gjithëpërfshirës në të gjitha Ministrinë e linjës, gjatë Fazës së I të përgatitjes së PBA 2017-2019, Grupi për Menaxhim Strategjik duhet të zhvillojë një takim konsultativ me përfaqësues të shoqërisë civile.
- b) Përfaqësuesit e Shoqërisë Civile në këtë takim do të njihet me produktet e planifikuara nga Ministrinë e linjës në PBA 2017-2019. Sugjerimet e përfaqësuesve të shoqërisë civile, së bashku me qëndrimet EMP-ve përkatëse lidhur me to (*pra EMP në çdo rast duhet të argumentojnë marrjen apo jo parasysh të sugjerimeve dhe pse*) duhet të jenë pjesë e një aneksi të veçantë, i cili do të dorëzohet në Ministrinë e Financave së bashku me kërkesat buxhetore të PBA.
- c) Pas përfundimit të seancave dëgjimore të Fazës së I, Ministria e Financave gjithashtu, do të organizojë një takim konsultativ me përfaqësuesit e shoqërisë civile. Në këtë takim do të diskutohet propozimi për shpërndarjen e burimeve buxhetore në përputhje me politikën e programeve buxhetore për periudhën 2017-2019, me fokus qëndrimin e shoqërisë civile mbi këtë propozim.
- d) Minutat e këtij takimi së bashku me aneksin e dorëzuar nga Ministrinë e linjës (referojuni pikës b) do të reflektohen në një aneks të veçantë të dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2017-2019.

4. Afatet për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2017-2019

- a) Datat kryesore të Kalendarit të Menaxhimit të Shpenzimeve Publike për vitin 2016, të detyrueshme për t'u zbatuar për qëllim të këtij Udhëzimi, janë:
 - Afati për dorëzimin e Kërkesave të Programit Buxhetor Afatmesëm 2017-2019 për **Fazën I**, në të cilën përfshihen edhe propozimet për investimet publike, **është deri më datë 02 maj 2016;**
 - Udhëzimi Plotësues i Përgatitjes së Buxhetit, duhet të shpërndahej tek Njësitë e Qeverisjes Qendrore pas miratimit të draftit të parë të Programit Buxhetor Afatmesëm 2017-2019 nga Këshilli i Ministrave, brenda datës **8 korrik 2016;**
 - Afati për dorëzimin e Kërkesave të Programit Buxhetor Afatmesëm 2017-2019 për **Fazën II**, është **deri më datë 1 shtator 2016;**
 - Datat e seancave dëgjimore të Programit Buxhetor Afatmesëm 2017-2019, për **Fazat I e II**, paraqiten në **Tabelën nr.2**, bashkëlidhur këtij Udhëzimi. Përkatësisht në periudhat **23 maj – 03 qershor 2016 dhe 26 shtator – 7 tetor 2016**, Ministria e Financave do të zhvillojë seancat dëgjimore me të gjithë anëtarët e Grupeve të Menaxhimit Strategjik të Njësive të Qeverisjes Qendrore. Në këto seanca do të marrin pjesë gjithashtu, përfaqësues nga Departamenti i Programimit të Zhvillimit të Financimeve dhe Ndihmës së Huaj, Ministria e Integritit Evropian, si dhe një përfaqësues për çështjet gjinore nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, në rolin këshillimor, gjatë të cilave do të diskutohen kërkesat për Programit Buxhetor Afatmesëm 2017-2019 të dërguara prej tyre. Në këto seanca do të jepen konkluzionet dhe rekomandimet përkatëse, sipas fushave përkatëse nga përfaqësuesit e institucioneve të sipërcituara, të cilat do të përfshihen në raportin përmbledhës të përgatitur nga Ministria e Financave, raport i cili u dërgohet zyrtarisht Njësive të Qeverisjes Qendrore.
- b) Ndëshkimet e parashikuara në nenin 71, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, do të zbatohen për nëpunësit autorizues në çdo rast të mundshëm të mosrespektimit të këtij udhëzimi.

5. Ndjekja e Procesit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2017-2019 dhe Mbështetja Këshillimore

- Ministria e Financave do të organizojë në ambientet e saj takime me të gjithë Nëpunësit Autorizues të Njësive të Qeverisjes Qendrore për të diskutuar progresin dhe shqetësimet që mund të lindin gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit. Këto takime do të organizohen përkatësisht në datat:
 - ⇒ Takimi i parë, ditën e Premte, datë 21 mars 2016, ora 11:00;
 - ⇒ Takimi i dytë, ditën e Premte, datë 18 prill 2016, ora 11:00.
- Ndjekja dhe zbatimi me përpikmëri e këtij Udhëzimi nga ana e Njësive të Qeverisjes Qendrore do të raportohet rregullisht nga ministri i Financave tek Komiteti i Planifikimit Strategjik dhe Këshilli i Ministrave.
- Ministria e Financave, në kuadër të mbështetjes këshillimore për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2017-2019, vë në dispozicion për çdo Njësi të Qeverisjes Qendrore adresën email: budget.programming@financa.gov.al.

ARBEN AHMETAJ

MINISTËR

